



Kolegji AAB

CILËSI. LIDERSHIP. SUKSESI!

Sjellja jo e mirë akademike **Manual dhe Rregullore**

Përmbajtja

Sjellje jo të mira akademike	3
Dispozitat	3
Definimet	3
Plagjiatura	3
Dorëzimi i punimit të njejtë më shumë se një herë.....	3
Marrëveshjet/bashkëpunimet e fshehta mes studentëve	3
Kopjimi gjatë provimeve dhe kollokfiumeve	4
Kopjime të tjera dhe mos referenca/citime adekuate.....	4
Rregullore dhe ndëshkime: Plagjiatura	4
Shkeljet e plagjiatures.....	8
Sjellje të tjera jo të mira akademike.....	9
Kopjimi në provime	9
Dorëzimi i shumëfishtë.....	9

Sjellje jo të mira akademike

Në Universitetin AAB, sjellje jo të mira akademike dhe pandershmëri akademike konsiderohen:

- Plagjiatura apo marrja e punimeve të tjera pa i theksuar referencat mirë
- Dorëzimi i punimit të njëjtë më shumë se një herë
- Marrëveshjet/bashkëpunimet e fshehta mes studentëve
- Kopjimi gjatë provimeve dhe kollokfiumeve
- Kopjime të tjera dhe mos referenca/citime adekuate

Këto janë specifikuar edhe në rregulloret për studime Bachelor dhe Master.

Më poshtë do të gjeni rregullat dhe ndëshkimet për sjelljet e listuara më lartë dhe nga një paragraf të shkurtër në lidhje me atë se si definojnë secila nga këto shkelja sipas Universitetit AAB.

Dispozitat

Ky dokument është përpiluar nga Zyra për Sigurimin e Cilësisë dhe vlen për vitin akademik 2014/2015 dhe 2015/2016. Pas kësaj periudhe kohore do të rishqyrtohet. Kjo aplikohet për të gjitha lëndët dhe për të gjithë studentët e Universitetit AAB.

Definimet

Plagjiatura

Plagjiatura është marrja e punimeve nga të tjerët pa ia bërë referencat mirë atyre. Më saktësisht, plagjiatura është përdorimi dhe prezantimi i punës, fjalëve, ideve të dikujt tjetër, si të ishin tuajat. Andaj, shumica e formave të kopjimit gjatë provimeve dhe shkrimit të raporteve ose eseve është plagjiaturë, por termi përdoret zakonisht kur referohemi te të shkruarit e letrave, hulumtimeve, detyrave me shkrim, eseve, temave të diplomimit, projekteve për diplomim, projekteve të ndryshme dhe raporteve.

Dorëzimi i punimit të njëjtë më shumë se një herë

Me këtë i referohemi rastit kur një student përpigjet ta dorëzojë punimin e njëjtë në më shumë se një lëndë pa modifikime dhe ndryshime përshtatëse për lëndën. Studenti mund të këtë të drejtën e dorëzimit të njëjtë punim në dy lëndë vetëm nëse ai/ajo student bie dakord paraprakisht me dy profesorët e lëndëve përkatëse.

Marrëveshjet/bashkëpunimet e fshehta mes studentëve

Me këtë u referohemi rasteve kur dy ose më shumë studentë mundohen të bashkëpunojnë mes vete duke e bërë dorëzimin e punimeve të njëjta se bashku, duke i dhënë njeri-tjetrit punimet e

tyre për dorëzim, duke u marrë veshë që t'i dorëzojnë punimet në një lëndë njeri, ndërsa tjetri në lëndën tjetër d.m.th. punimet e njëjta, duke u munduar që të marrin detyra nga kolegë dhe studentë të fakulteteve të tjera publike dhe private dhe t'i dorëzojnë në Universitetin AAB si punime të tyre.

Kopjimi gjatë provimeve dhe kollokfiumeve

Kopjimi gjatë provimeve dhe kollokfiumeve apo testimeve të ndryshme është i ndaluar në Universitetin AAB. Nëse studenti vërehet nga profesori apo asistenti, apo edhe nga mbikëqyrësi i provimeve, kollokfiumeve dhe testimeve të ndryshme, se ai/ajo student ka kopjuar në mënyra të ndryshme në test, profesori ka të drejtën e largimit nga salla studentin dhe anulimin e testit të studentit.

Kopjime të tjera dhe mos referencat /citime adekuate

Me këtë u referohemi rasteve kur studentët nuk e tregojnë të vërtetën e burimeve që kanë përdorur në shkrimet apo punimet e tyre. Mund të këtë raste kur studentit shkruan për fakte të ndryshme që i merr nga një burim, mirëpo në citim dhe në bibliografi jep referenca të burimeve jo ekzistuese ose të tjera. Mos citimet adekuate sipas sistemeve apo stileve të referencave gjithashtu mund të konsiderohen shkelje të rregullave akademike në shkrim. Ju duhet ta lexoni me vëmendje udhëzuesin për referenca dhe citim të Universitetit AAB.

Rregullore dhe ndëshkime: Plagjiatura

1. Plagjiatura është përdorimi dhe prezantimi i punës, fjalëve, ideve të dikujt tjetër, si të ishin të studentit. Andaj, shumica e formave të kopjimit gjatë provimeve është plagjiaturë, por termi përdoret zakonisht në referencë të letrave, hulumtimeve, detyrave me shkrim, eseve dhe raporteve.
2. Si e tillë, në qoftë se do të përdorni punën e dikujt tjetër, ju duhet t'i bëni referencat në mënyrë të përshtatshme sipas kriterëve të citimit. Çdo citat nga veprat e botuara apo të pabotuara të autorëve të tjerë, duhet të identifikohet qartë duke u vendosur brenda thonjëzave, dhe studentët duhet t'i identifikojnë burimet e tyre saktë dhe sa më të plota që të jetë e mundur.
3. Plagjiatura përfshin:
 - Kopjimi dhe bartja e informacionit nga burimi elektronik apo i shtypur në punimin tuaj pa e cituar atë.
 - Marrëveshjet e fshehta, ku dy apo më shumë studentë punojnë në të njëjtën temë dhe e shfaqin atë si punë të tyre individuale.
 - Blerja e punimeve dhe paraqitja e tyre si punime tuajat, qofshin këto punime ekzistuese apo të shkruara më herët, duke përfshirë edhe faqet në internet që e mundësojnë këtë shërbim.
 - Ndryshimi i fjalive, por kopjimi i strukturës së fjalisë, pa ia bërë referencat .

- Kopjimi i shumë ideve dhe fjalive nga një burim i vetëm, e cila përbën një pjesë të madhe të punimit tënd.
- Dorëzimi i punimit më shumë se një herë.
- Mos referenca e punës – Përdor sistemin Harvard ose Vancouver të referencave .
Ju lutem shikoni udhëzuesin për këtë. Ju mund të përdoreni edhe sisteme të tjera të referencave, por duhet konsultuar me profesorin e lëndës paraprakisht.
- Përkthimi i fjalive nga një gjuhë tjetër, pa e referencuar atë në mënyrë adekuate.

4. Rregulla dhe udhëzime:

- i. Gjatë shkrimit të punimit tuaj, është në rregull përdorimi i punës së tjetrit, por nëse përdoren si duhet rregullat e citimit, respektivisht sistemet e ndryshme të referencave dhe citimit (p.sh. Stili Chicago, APA, Harvard apo Vancouver i citimit). Ju duhet ta lexoni udhëzuesin për këtë.
- ii. Është me rëndësi përdorimi i shumë burimeve të ndryshme për një temë të caktuar në shkrimin e punimit tuaj, përderisa atyre iu bëhen referencat mirë dhe saktë. Profesori mund t'ju vlerësojë për referencat e burimeve të ndryshme. Kjo tregon se keni hulumtuar dhe lexuar shumë burime/artikuj.
- iii. Çmoje burimin duke e cituar atë në shkrimin tënd dhe duke i dhënë referencë të plotë në fusnotë apo në listën e referencave në fund të punimit apo duke përdorur referenca të sistemeve të referencave. Të gjitha referencat në fund të shkrimit tuaj të listuara quhen "Bibliografi", dhe kjo duhet të jetë pjesë e veçantë e punimit tuaj.
- iv. Syllabusi i një lënde e cila si metodë vlerësimi ka edhe shkrime akademike, duhet të tregojë format e citimit që profesori pret të shohë në shkrimet tuaja. Nëse gjatë shkrimit tuaj ju merrni fjalë për fjalë tekstin nga një libër tjetër, atëherë tekstin e marrë duhet ta fusni në thonjëza. Citime të tilla mund të jenë të përshtatshme për shkrimin tuaj por duhet të respektohen rregullat. Gjithsesi, nëse përdorni shumë citate në punimin tuaj, kjo nuk është plagjiaturë, por ky nuk është shkrim/punë e juaj, andaj ju mund të notoheni me notë më të dobët për këtë.
- v. Në rastin e ideve të njerëzve të tjerë, mund të jetë e vështirë të përcaktoni se çfarë duhet të citoni e çfarë jo. Kjo për shkak se ka “njohuri të përbashkëta” për temën dhe nivelin e studimit. Nëse nuk jeni të siguritë se cilat ide duhet cituar, atëherë ju duhet të konsultoheni me ligjëruesin apo profesorin tuaj, apo një përfaqësues nga Zyra për Sigurimin e Cilësisë. Nëse jeni të pasiguritë, është më mirë të siguroheni duke e cituar atë.
- vi. Informatat e marra nga interneti duhet të citohen njëjtë si informatat e marra nga librat apo gazetat, dhe ju duhet të jepni datën kur jeni qasur në informacion.
- vii. Referencat e gjithë punës duhet bërë në përputhje me udhëzuesin e Universitetin AAB, për Citime dhe Referenca. Një udhëzues i veçantë është përgatitur për ju për mënyrat e ndryshme të citimit dhe referencave për shumicën e sistemeve

ndërkombëtare për citim dhe referenca.

- viii. Plagjiatura është plagjiaturë pavarësisht nëse e keni bërë me qëllim apo pa qëllim. Studentët duhet të sigurohen se i kuptojnë parimet e të çmuarit të punës së tjetrit dhe duhet ta citojnë në mënyrë të duhur atë, sipas rregullave akademike.
- ix. Kjo rregullore i dallon plagjiaturat e vogla dhe ato të mëdha apo shkeljet e vogla dhe ato të mëdha.
- a. Plagjiaturë në masë të vogël karakterizohet nga kuotimet të pa-atribuara; parafrazime të papërshtatshme ose zëvendësim i fjalëve në tekst; mos citimi, citimi i pasaktë ose i paplotë, dhe/ose kopjimi i disa paragrafëve pa citim të burimit. Parafrazimi i papërshtatshëm është plagjiaturë – pra marrja e tekstit të dikujt tjetër dhe riorganizimi apo zëvendësimi i fjalëve për të fshehur atë.
- b. Plagjiaturë në masë të madhe karakterizohet kopjimi i shumë paragrafëve nga burimet publike duke mos i cituar ato; apo dorëzimi i punimit të njëjtë më shumë se një herë dhe për disa lëndë (pa lejen e profesorit), punimi që nuk ka fare referenca; apo tentimi ose blerja e punimeve nga studentët e tjerë, apo web faqet të cilat merren me këto shërbime.
- x. Ka ngjashmëri në mes të bashkëpunimeve të vogla dhe të mëdha. Keni parasysh se dorëzimi i punimit të dikujt tjetër si i juaji është shkelje akademike.
- xi. Nëse profesori dyshon në punën tuaj për plagjiaturë, atëherë ai/ajo do të përpiket që të gjejë burimin. Edhe në qoftë se profesori nuk mund të gjejë burimin, por prapë dyshon për plagjiaturë, ai mund të kërkojë nga dekanati të vërtetojë këtë. Nëse punimi ka plagjiaturë, Dekanati do të njoftojë profesorin dhe do të ftojë studentin në bashkëbisedim për të diskutuar këtë problem. Nëse studenti mungon, ai/ajo mund të përfaqësohet nga një anëtar tjetër i Universitetit, por kësaj duhet me çdo kusht t'i shmanget studentit.
- xii. Nuk kërkohet një provë absolute për të dëshmuar plagjiaturën. Mjafton të dyshohet që ka pasur plagjiaturë nga profesori dhe dekanati dhe për të vendosur që studentit ka bërë shkelje akademike nuk është nevoja të dalim “përtej dyshimit të arsyeshëm ose logjik”.
- xiii. Duhet bërë dallimi mes shkeljes së parë, dytë, tretë e të tjera.
- a. Shkeljet e para të vogla trajtohen si gabime për shkak të kuptimit të dobët të shkrimit akademik. Kjo kategorizohet si "punë e papranueshme"; punimi nuk pranohet dhe duhet të korrigjohet. Kjo përbën veprën e parë dhe regjistrohet në dosjen e studentit.
- b. Shkelja e dytë është kur përsëritet rasti – pra, nëse studentit pavarësisht vërejtjes së parë vazhdon për herë të dytë me të njëjtën shkelje.

- c. Të gjitha shkeljet regjistrohen. Profesori/ligjëruesi do të mbajë shënime për detajet e rastit. Shënimet për shkelje mbahen të hapura derisa studenti të përfundojë programin e studimit.
 - d. Nëse vërtetohet se për rastet e hapura nuk ka shkelje, rasti nuk regjistrohet.
 - e. Pasi që është marrë vendimi, studenti mund të apelojë kundër vendimit, por vetëm në aspektin e parregullsisë procedurale.
- xiv. Të gjitha shkeljet referohen nga ligjëruesi te dekanati. Dekanati fton studentin për bashkëbisedë me dekanin dhe profesorin/ligjëruesin. Profesori/ligjëruesi paraqet rastin dhe studenti intervistohet më pas, me një përfaqësues, në qoftë se studenti dëshiron ose e sheh të nevojshme, por i cili duhet të jetë një anëtar i universitetit.
- a. Paneli intervistues mund t'i merr parasysh të gjitha rrethanat në të cilat ishte studenti.
 - b. Paneli mund të rekomandojë ndonjë ndëshkim, dhe studenti mund të përjashtohet në këtë fazë. Në rast të bashkëpunimit të studentëve, ku profesori nuk mund të vërtetojë fajësinë e secilit student veç e veç, profesori mund të refuzojë punimin e të gjithë studentëve në të cilët dyshon për plagjiaturë apo bashkëpunim. Punimet konsiderohen si “punime të papranueshme” dhe mund të kërkohet që brenda një afati të caktuar kohore punimi të ri-dorëzohet i korrigjuar. Në rast se profesori identifikon fajtorin, studenti në fjalë trajtohet sipas tabelës një (1) më poshtë.
- xv. Studentët e ftuar në intervistë nga dekanati dhe paneli intervistues, duhet të konsultohen me profesorin e tyre paraprakisht.
- xvi. Tabela e mëposhtme tregon nivelin e ndëshkimeve për raste të ndryshme në Universitetin AAB. Kjo aplikohet për të gjitha lëndët dhe të gjithë studentët e Universitetit AAB.

Shkeljet e plagjiaturës

	Shkelja e parë	Shkelja e dytë	Shkelja e tretë dhe të tjerat
Të vogla	<p>Notën origjinale, (nëse studenti në atë punim të lëndës është notuar njëherë por më vonë është dyshuar për plagjiaturë), e merr në momentin që dorëzon versionin e pranueshëm.</p> <p>Nota finale do t'i jepet sipas meritës, por nuk do të tejkalojë notën origjinale që iu është dhënë në punim.</p> <p>Nga studenti kërkohet që të merr udhëzime të përshtatshme dhe praktike në shkrim akademik.</p> <p>Krijohet dosja e studentit për sjellje jo të mira akademike. Në dosjen e studentit regjistrohet sjellja jo e mirë akademike.</p>	<p>Studenti merr paralajmërim me shkrim për sjellje jo të mirë akademike dhe vlerësim me notën zero për punimin përkatës, dhe me pasoja në rivlerësim.</p> <p>Krijohet dosja e studentit për sjellje jo të mirë akademike. Në dosjen e studentit regjistrohet sjellja jo e mirë akademike.</p>	<p>Studenti drejtohet te dekanati:</p> <p>Vërejtje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Nota për lëndë/modul limitohet në minimum, studenti mund të marrë vetëm notë kaluese (6 gjashtë) nëse përfshihet në ndonjë rivlerësim. 2. Vendosja e notës zero nënkupton që të gjitha metodat/komponentët e vlerësimit të vlerësohen me zero, pavarësisht nëse është vlerësimi i parë apo rivlerësim. 3. Studenti duhet ta rimarrë lëndën vitin ose semestrin që vjen. (apo t'i dëgjojë të gjitha ligjëratat nga fillimi dhe t'u nënshtrohet të gjitha provimeve, kollokviumeve etj. të lëndës)
Të mëdha	<p>Studenti merr paralajmërim me shkrim për sjellje jo të mirë akademike dhe vlerësim me notën zero për punimin përkatës, dhe me pasoja në rivlerësim.</p> <p>Krijohet dosja e studentit për sjellje jo të mirë akademike. Në dosjen e studentit regjistrohet sjellja jo e mirë akademike.</p>	<p>Studenti merr paralajmërim me shkrim për shkelje akademike dhe merr notimin me notën zero për të gjithë lëndën.</p> <p>Studentit i kërkohet të përsërite tërë lëndën/modulin në vitin apo semestrin tjetër akademik.</p> <p>Krijohet dosja e studentit për sjellje jo të mirë akademike. Në dosjen e studentit regjistrohet sjellja jo e mirë akademike.</p>	<p>Studenti drejtohet në dekanat dhe në rektorat.</p> <p>Vërejtje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Studenti përjashtohet nga universiteti.

Tabela 1: Rregullorja për plagjiaturë dhe ndëshkimet në Universitetin AAB

Sjellje të tjera jo të mira akademike

Kopjimi në provime

5. Kopjimi i përgjigjeve nga studentët e tjerë, apo referimi pa leje në libra, kompjuterë, laptopë, dhe/apo referimi të shënimit në telefon mobil. Gjithashtu, përdorimi i telefonave për të diskutuar apo marrë përgjigjet nga një student tjetër, pavarësisht nëse është prezent në klasë apo jo, është i ndaluar.
6. Mashtrim apo kopjim është gjithashtu edhe ndryshimi i pyetjeve në provim dhe pastaj të kërkohet vlerësim. Është përgjegjësi e studentit të dorëzojë provimin ashtu siç e ka pranuar; çdo ndryshim është sjellje jo e mirë akademike.
7. Për provimet “me libër të hapur”, ose për provimet shtëpiake (ku studenti e merr provimin në shtëpi dhe përgjigjet në pyetjet e provimit), ose për provimet me pyetje të cilave jepen paraprakisht, profesorët duhet t’i bëjnë të qarta rregullat, dhe studentët duhet t’u përmbahen atyre.
8. Nëse një student është në hamendje për sa i përket kuptimit të udhëzimeve, ai ose ajo duhet të kërkojë sqarim nga profesori. Pritja e zakonshme është që çdo student do t’i përgatisë përgjigjet e tij ose të saj vetë; bashkëpunim me të tjerët është e pranueshme vetëm nëse është kërkuar nga profesori të punohet në grupe. Në të gjitha rastet, përgjigjet që studenti i dorëzon duhet të përfaqësojnë mendimet dhe të kuptuarit e tij. Nëse studenti mendon se përgjigjet e tij/saj janë të ndikuara nga librat apo mendimet e të tjerëve, duhet ta cek këtë në punim dhe t’i citojë/referencojë burimet.
9. Mund t’i drejtoheni tabelës (tabela 1) më lartë për ndëshkimet e parapara.

Dorëzimi i shumëfishtë

10. Studentët nuk duhet të dorëzojnë të njëjtin punim në më shumë se një lëndë apo me shumë se një herë. Nëse temat për dy punimet përputhen, studenti duhet të ketë leje të shkruar nga dy profesorët e lëndëve para se të kombinojë punën në dy punime apo të rishikojë/riorganizojë punimin e mëparshëm dhe ta dorëzojë atë për lëndën e re.
11. Mund t’i drejtoheni tabelës (tabela 1) më lartë për ndëshkimet e parapara.

Copyright © 2014: AAB University, Kosovo

Nga:

**Zyra për Sigurim
të Cilësisë**

Universiteti AAB
Objekti 1
Fushe Kosove

Universiteti AAB, Kosovë

<http://www.universitetiaab.com/>

<http://www.aab-edu.net/>



BPrAL AAB
CILËSI. LIDERSHIP. SUKSESI